



## Periodiku AMF

**Mbi raportimin pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2008**

Më datë 30 mars 2009, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit për vitin 2008.

*Vijon në faqen 2*

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura**

**Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar – shkurt 2009**

Në periudhën janar – shkurt 2009, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 1,263,302 mijë lekë, përkundrajt 956,235 mijë lekë të realizuara në vitin 2008.

*Vijon në faqen 3*

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera**

**Prezantim i Kryetares së AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, në takimin e punës mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare ndërkufitare - kuadri i zbatimit**

Në datat 16 - 19 mars 2009, u zhvillua në Joint Vienna Institute, Austri, takimi i punës mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare ndërkufitare - kuadri i zbatimit, organizuar nga Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë dhe Banka Botërore.

*Vijon në faqen 4*

**Zhvillohet seminari mbi aftësinë paguese me bazë risku**

Instituti i Stabilitetit Financiar në bashkëpunim me BIS Bankë, organizoi në datat 17-19 mars 2009, Bazel, seminarin në lidhje me aftësinë paguese me bazë risku. Në seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore në botë.

*Vijon në faqen 5*

**Pjesëmarrje në mbledhjet e IAIS**

Në datat 3-6mars 2009, në Bazel, Zvicër, u zhvilluan mbledhjet e rregullta tre mujore të IAIS.

*Vijon në faqen 6*

**Zhvillohet konferenca mbi edukimin e konsumatorëve, krijimi dhe shpërndarja e programeve të suksesshme**

IOSCO, në bashkëpunim me IFIE (Forumi Ndërkombëtar për Edukimin e Investitorëve) organizuan në datat 2-3 mars 2009, Washington DC, konferencën, mbi edukimin e konsumatorëve, krijimi dhe shpërndarja e programeve të suksesshme.

*Vijon në faqen 8*

**Edukimi i konsumatorit**

Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve (Pjesë e shkëputur nga Botimi i IOPS: “Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve”)

**Udhëzimi 2 : Kërkesat e Raportimit**

Kërkesat themelore të raportimit duhet të aplikohen për të gjitha fondet e pensioneve.

*Vijon në faqen 9*

Në këtë numër:

Mbi raportimin pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2008

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

4

Edukimi i konsumatorit

9

## Mbi raportimin pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2008



Zj. Gjoni, gjatë raportimit në Komisionin e Ekonomisë

Më datë 30 mars 2009, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit për vitin 2008. Në fjalën e saj, Zj. Gjoni bëri një përmbledhje të veprimtarisë, përpjekjeve dhe arritjeve të AMF-së në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri. Në raportim u paraqit ecuria e tregjeve financiare jo-bankare gjatë 2008, mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, me fokus zhvillimet e veçanta që shoqëruan këto tregje gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2008, veprimtaria e AMF-së vijoi të mbështesë misionin themelor të mbrojtjes së

interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi, të lidhur ngushtë me stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyrur. Sektori i sigurimeve, mbajti peshën kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri dhe për këtë arsye pati vëmendjen e veçantë dhe fokusimin e pjesës më të madhe të burimeve dhe kapaciteteve të AMF-së.

**Tregu i letrave me vlerë** në fokusin e AMF-së edhe në 2008 përbëhej nga tregu me pakicë i instrumenteve të borxhit të Qeverisë. Platforma elektronike GSRM, i ka shërbyer publikut dhe ka rritur transparencën për kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Konkretisht, ajo ka përditësuar në kohë reale informacionin mbi nivelin e kërkesës ofertës dhe transaksionet në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë, çfarë e ka shndërruar atë në një nga rubrikat më të klikuara në faqen web të AMF-së, ndërsa tregu i pensioneve private është në fillimet e tij në Shqipëri. Gjatë vitit 2008, në këtë treg vijuan të ushtrijnë veprimtarinë tre operatorë.

AMF ka bërë një punë të madhe në drejtim të hartimit të katër projektligjeve bazë dhe shumë akteve nënligjore, që rregullojnë sektorin financiar jo-bankar.

Janë hartuar: projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili u miratua në Kuvendin e Shqipërisë, shkurt 2009, projektligji “Për fondet e pensioneve vullnetare”, projektligji “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, si dhe projektligji “Mbi obligacionet e shoqërive aksionere dhe qeverisë vendore”. Procesi i përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit, është mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare, Direktivat Evropiane dhe ka pasqyruar përvoja të suksesshme të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

**Në raportim u cilësua dhe monitorimi dhe mbikëqyrja e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri, si funksion themelor i AMF-së.** Për këtë arsye, vëmendje e veçantë dhe burime të

konsiderueshme i janë kushtuar sjelljes së tregjeve, gjendjes financiare të operatorëve, si dhe tendencave dhe problematikave të zhvillimit të tyre. Puna e monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare, ka konsistuar në një kombinim harmonik të inspektimeve në vend me analizat e plota të gjendjes financiare e treguesve të operatorëve, si dhe monitorimin e përputhjes së veprimtarisë me kuadrin ligjor në fuqi.

Bashkëpunimi i AMF-së me institucione brenda vendit, i ka shërbyer njëkohësisht efektivitetit në rregullimin e mbikëqyrjes së tregut dhe krijimit të hapësirave të zhvillimit të produkteve financiare, ndërsa komunikimi me tregjet dhe konsumatorin ka shënuar rritje.

Krahas bashkëpunimit institucional brenda vendit, me të gjithë aktorët, palët e interesuara dhe publikun, AMF ka forcuar kontaktet dhe komunikimin me analogët ndërkombëtarë në fushën e rregullimit e mbikëqyrjes dhe ka përfituar asistencë teknike shumë të vlefshme nga institucionet ndërkombëtare financiare.

Raporti i plotë i veprimtarisë, iu vu në dispozicion anëtarëve të Komisionit, të cilët vlerësuan pozitivisht punën e institucionit dhe bënë pyetje e komente të ndryshme në lidhje me zhvillimet në tregjet e mbikëqyrura dhe veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2008.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar-shkurt 2009

Në periudhën janar – shkurt 2009, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 1,263,302 mijë

lekë, përkundrajt 956,235 mijë lekë të realizuara në dymujorin e parë të vitit 2008.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 32.11% nga viti i kaluar, ku 77.14% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 29.33% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 14% të sigurimeve të Jetës dhe 86% të sigurimeve të Jo-Jetës.

Gjatë kësaj periudhe volumi i primeve të sigurimi të detyrueshëm është rritur në masën 10.14%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo-Jetës është rritur në masën 72.95% dhe u lidhën 104,845 kontrata sigurimi përkundrajt 82,577 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2008. Numri i kontratave të sigurimit të Jo-Jetës kapi vlerën 97,319 nga 74,869 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli “Sigurimi i shëndetit” ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 20,055 kontrata ose në masën 60.43% më shumë se në janar – shkurt 2008.

Vlen të përmendet ulja në masën 2.36% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 7,526 nga të cilat sigurimi “Jetë e kombinuar” ka një rritje prej 635 kontrata, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar – shkurt 2009 kapi vlerën 237,290 mijë lekë, ose 12.73% më shumë se në periudhën janar – shkurt të vitit 2008. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 213,174 mijë lekë, apo 89.84 % të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 5.32% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 34.33% krahasuar me vitin 2008.




Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar – shkurt (2008 – 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2008	2009
<b>Periudha janar - shkurt</b>		
A) Sigurim i Jetës	55,721	98,704
B) Sigurim i Jo - Jetës	900,515	1,164,597
<i>nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	625,461	688,904
b) Sigurimi Vullnetar	275,054	475,693
<b>TOTAL</b>	<b>956,235</b>	<b>1,263,302</b>

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - shkurt 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar - shkurt 2009 (Jo-Jeta)



## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Prezantim i Kryetares së AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, në takim të punës mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare ndërkufitare - kuadri i zbatimit

Në datat 16 - 19 mars 2009, u zhvillua në Joint Vienna Institute, Austri, takimi i punës mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare ndërkufitare - kuadri i zbatimit, organizuar nga Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë dhe Banka Botërore.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të niveleve më të larta nga autoritete rregullatore / mbikëqyrëse financiare dhe institucione financiare ndërkombëtare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) u përfaqësua nga Kryetarja Zj. Elisabeta



Gjoni, e cila ishte njëkohësisht edhe anëtare në panelin e sesionit të datës 19 mars me temë: **"Qasja me sfidat e problemeve të mbikëqyrjes ndërkufitare në praktikën e mbikëqyrjes së sigurimeve"**.

Në prezantimin e saj mbi **"Sfidat e mbikëqyrjes së sigurimeve"**, Kryetarja Gjoni trajtoi (i) *elementë të zhvillimit të sigurimeve në vendet e rajonit*, (ii) *probleme dhe sfida të rregullimit dhe mbikëqyrjes në vendet në zhvillim*, (iii) *rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimit të përvojës midis rregullatorëve dhe (iv) qasjen e masat, përkundrejt efekteve të mundshme të krizës financiare*. Ajo paraqiti një tablo konkrete të problemeve dhe sfidave të AMF-së, si rregullator dhe mbikëqyrës i integruar i sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri dhe qasjen e këtij institucioni në përbashkëtimin e tyre.

Në kuadrin e tematikës dhe frymës së përgjithshme të takimit të punës, Zj. Gjoni vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit në rritje me FMA-në Austriake, në drejtim të mbikëqyrjes ndërkufitare dhe shkëmbimit të eksperiencës. Takimet e ndërsjellta, me synim mbikëqyrjen ndërkufitare, kanë përfshirë nivelet më të larta dhe janë shoqëruar më tej me asistencë teknike të ofruar nga FMA Austriake për çështje të mbikëqyrjes së bazuar në risk dhe ndërtimin e një sistemi bashkëkohor të menaxhimit të informacionit.

Si shembull pozitiv i bashkëpunimit në mbikëqyrjen ndërkufitare, u përmend edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në fund të vitit 2008, për shkëmbimin e përvojës dhe mbikëqyrjen ndërkufitare të sektorëve financiarë jo-bankarë dhe trajnimeve të përbashkëta.

Zj. Gjoni, vlerësoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare drejt ndërtimit të sistemeve bashkëkohore të rregullimit dhe mbikëqyrjes, të bazuara në standardet e IAIS-it dhe parimet e njohura ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ajo përmendi projektet në proces të AMF-së me Bankën Botërore dhe Bankën Evropiane për

Rindërtim dhe Zhvillim për përmirësimin e kuadrit ligjor, hartimin e metodologjisë së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe mbështetjen në një platformë tërësisht elektronike të raportimit.

## Zhvillohet seminari mbi aftësinë paguese me bazë risku

Instituti i Stabilitetit Financiar në bashkëpunim me BIS Bankë, organizoi në datat 17-19 mars 2009, Bazel, seminarin në lidhje me aftësinë paguese me bazë risku. Në seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore në botë.

Çështjet kryesore për diskutim u mbuluan nga një numër prezantimesh të mbajtura nga ekspertë të nivelit të lartë lidhur kryesisht me: *Rolin e menaxhimit të riskut, vlerësimin me bazë tregun të rezervave, çështje lidhur me asetet dhe kapitalin ekonomik, përdorimin e modeleve të brendshme për qëllime të riskut dhe menaxhimit të kapitalit, etj.*

Gjatë Seminarit u theksua se:

- o Mbikëqyrësit duhet të binden se siguruesit i kuptojnë rreziqet me të cilat ata ballafaqohen dhe për më tepër ata zbatojnë praktika të mira të menaxhimit të rreziqeve. Ky është një fakt i vënë në dukje edhe nga kriza financiare që po kalon bota. Projekti për Solvency II i EU dhe IAIS, fokusohet në përafrimin e teknikave të menaxhimit të rrezikut me standardet e aftësisë paguese, me qëllim që këto të fundit të jenë të ndjeshme ndaj rreziqeve.
- o Modelet e kapitalit ekonomik janë të rëndësishme në industrinë e sigurimeve dhe është ecur në drejtim të matjes sasiore të rreziqeve. Meqenëse këto modele paraqesin edhe të meta, siguruesit duhet të zgjerojnë këto modele edhe me masa cilësore, si p.sh stress testing dhe analizën e skenarëve. Në të njëjtën kohë, mbikëqyrësit duhet të

monitorojnë përshtatshmërinë e këtyre praktikave.

- o Një regjim i aftësisë paguese të ndjeshme ndaj rreziqeve, shpesh shoqërohet me një vlerësim konsistent sipas tregut të asetëve dhe detyrimeve. Përcaktimi i vlerave të tregut lehtësohet kur ekzistojnë tregje likuide. Këto tregje rrallë ekzistojnë për detyrimet dhe vlera e provigjoneve teknike nuk do të mund të matet sipas tregut. Në këto kushte, ato do të maten bazuar në modele dhe në këtë rast sfida është që të gjendet një model vlerësimi i përshtatshëm dhe i pranueshëm.

## Pjesëmarrje në mbledhjet e IAIS

Në datat 3-6 mars 2009, në Bazel, Zvicër, u zhvilluan mbledhjet e rregullta tre mujore të IAIS.

Pjesëmarrja e autoriteteve mbikëqyrëse në këtë takim, sikurse edhe në takimet e tjera paraardhëse, i shërben zhvillimit dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes, shkëmbimit të informacionit apo të pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut të sigurimeve, si dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse.

Përfaqësuesit e AMF-së, sipas një axhende të përzgjedhur paraprakisht, *morën pjesë në takimet e Komitetit Ekzekutiv të IAIS, Grupit të Punës të Nënshkruesve të MMoU, Nënkomitetit të Ligjeve të Sigurimeve Task Force për mbledhjen e informacionit dhe analizës së tij, të Nënkomitetit të Koordinimit Rajonal, Komitetit të Implementimit dhe Nënkomitetit të Qeverisjes dhe Miratimit (Governance & Compliance).*

### ➤ Grupi i Punës të Nënshkruesve të MMoU

**Qëllimi i MMoU**, është krijimi i një baze formale për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mes autoriteteve nënshkruese, në

lidhje me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve, kur bëhet fjalë për transaksione ndërkufitare. Një prej organeve kompetente të procesit të nënshkrimit është **Grupi i Punës i Nënshkruesve (GPN)**, i cili përbëhet nga të gjithë vendet që kanë nënshkruar MMoU dhe është organi përgjegjës për: Përcaktimin e grupeve të vlerësuesve, ndërmjetësimin mes anëtarëve dhe organeve të IAIS në lidhje me MMoU, rishikimin e funksionimit dhe efektivitetit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioni sipas MMoU dhe raportimin tek Komiteti i Zbatimit për çështjet e sipërpërmendura.

Në këtë takim:

- o U vu re një interes i madh nga entet rregullatore pjesëmarrëse për nënshkrimin e MMoU, u diskutuan mjaft detaje kryesisht lidhur me mënyrat e ruajtjes së konfidencialitetit, si dhe procedurat burokratike të procesit.
  - o Sipas Sekretariatit të IAIS, është në rritje numri i vendeve (juridiksioneve) që kanë shprehur interesin për nënshkrimin e MMoU.
  - o Mbi 17 vende kanë paraqitur zyrtarisht pranë sekretariatit të IAIS aplikimet e tyre për nënshkrimin e MMoU. Këto aplikime përfaqësojnë vende nga rajone të ndryshme gjeografike të botës.
  - o GPN u krijua në 22 shkurt 2008. Aktualisht në përbërjen e tij bëjnë pjesë Australia, Gjermania, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Britania e Madhe.
- Në takim u theksua, se GPN do të punojë për zhvillimin e një instrumenti që do të ndihmojë juridiksionet anëtare të IAIS gjatë procesit të aplikimit, vlerësuesit gjatë procesit të vlerësimit, si dhe do të sigurojë nivel të lartë konfidencialiteti dhe arshivim elektronik të dokumentacionit.

### ➤ Takimet e Komitetit Ekzekutiv të IAIS (KE)

Në këto takime u paraqit raporti mbi përgatitjen e propozimeve për takimet e ardhshme të KE, ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme të IAIS në

kuadrin e krizës financiare, forcimi i mëtejshëm i lidhjeve midis IAIS dhe G20, zgjerimi i rolit të IAIS në FSF, raporti për zhvillimin e MMoU, përgatitjet për konferencën vjetore dhe përmbajtja e programit të kësaj konference.

Në takimet e këtij komiteti u theksua se IAIS tashmë është i ndërgjegjshëm që procesi i vendosjes dhe zbatimit të parimeve bazë (CP), duhen mbështetur fuqimisht edhe nëpërmjet iniciativave edukuese dhe trajnuese të anëtarëve të tij për të lehtësuar zbatimin efektiv të parimeve bazë (CP).

#### ➤ **Nën Komiteti i Ligjeve të Sigurimeve**

Ky nënkomitet ka si aktivitet të tij mbajtjen dhe përditësimin e data base të ligjeve të sigurimeve (ILD) me mbështetjen edhe të nënkomitetit të Koordinimit Rajonal.

ILD është një instrument lehtësues online, i cili përmbledh të dhëna rreth ligjeve, rregullave dhe praktikave të juridiksioneve anëtarë të IAIS, si dhe siguron akses dhe krahasim të aspekteve të ndryshme ligjore, kontribuon për kuptimin dhe përmirësimin e sistemeve të ndryshme të mbikëqyrjes.

Secili juridiksion plotëson anketën në formë elektronike on line dhe përditëson ndryshimet vjetore.

Në takim u theksua rëndësia e koordinimit të punës midis ILD dhe grupeve të punës të IAIS, meqenëse si data base i ligjeve dhe parimet bazë të IAIS duhet të reflektojnë apo të jenë në përputhje me standardet apo dokumentet e hartuara nga grupet e punës.

Në takim nga ana e kryetarit të këtij nënkomiteti u kërkua disa herë përfshirja dhe angazhimi i anëtarve të rinj në të për të kontribuar konkretisht në përmbushjen e detyrave të këtij nënkomiteti dhe për forcimin e tij.

#### ➤ **Task Forca për grumbullimin dhe analizën e informacionit**

Në takim u diskutua gjerësisht në lidhje me anketimin e përgatitur nga ky grup dhe të

shpërndarë për t'u plotësuar nga 54 juridiksione anëtare të IAIS, si dhe informacioni i marrë nga këto juridiksione. Qëllimet kryesore të këtij anketimi ishin të identifikonin:

- o nëse informacioni minimal statistikor, financiar dhe teknik që duhet të disponohet gjatë procesit të mbikëqyrjes përputhej me praktikrat ekzistuese të mbikëqyrësve,
- o nëse ka tregues, çështje që mungojnë apo nuk zbatohen gjatë procesit të mbikëqyrjes,
- o nëse niveli i detajeve ishte i mjaftueshëm.

Kjo anketë u plotësua nga 54 vende të grupuara në 4 grupe, si: Amerika, Azia dhe Oqeania, Evropa Qendrore dhe Lindore, pjesë e të cilit ishte dhe Shqipëria, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore. Në takim u vlerësua puna e bërë nga koordinatorët rajonal për përpunimin e të dhënave të plotësuar nga juridiksionet, si dhe përgjigjet e dhëna apo komentet dhe sugjerimet e bëra nga vendet për përmirësimin e kësaj ankete. Në këtë seancë, gjatë diskutimit në lidhje me plotësimin e anketës, në grupin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Shqipëria u përmend disa herë për plotësim të drejtë dhe të vërtetë të kësaj ankete.

#### ➤ **Nënkomiteti i Koordinimit Rajonal**

Në këtë takim, koordinatorët rajonal, raportuan në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve rajonale. Për rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Transkaukazinë, raportoi koordinatori polak Mirosław Raczkowski.

Në materialin e prezantuar nga koordinatori, në seksionin “ zhvillime të tjera në rajon” u raportua për zhvillimet që ka pësuar AMF. Konkretisht u raportuan:

- o Ndryshimet ligjore, sikurse ishte hartimi i draftitligjit të ri të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
- o Licencimi për herë të parë i vlerësuesve të dëmeve dhe brokerit të parë në shtator të vitit 2008.
- o Në rubrikën projekte në zbatim, u përmendën, projekti i zbatimit të mbikëqyrjes më bazë

risku, projekti për sistemin e menaxhimit të informacionit dhe projekti për regjistrin on line të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm.

- o Në rubrikën trajnime, u përmend pjesëmarrja në shkollën verore aktuariale në Poloni (shtator 2008), pjesëmarrja në seminarin e FSI në lidhje me mbikëqyrjen me bazë rrisht Zvicër (30 shtator 2 tetor 2008).
- o Trajnimi i stafit të AMF në lidhje me zbatimin e IFRS, organizuar nga instituti i trajnimeve Maltë (Dhjetor 2008).

Në këtë takim, raportoi edhe Kryetari i Nënkomitetit të Ligjeve në lidhje me ecurinë e data base të ligjeve të sigurimeve, duke dhënë statistika në lidhje me vendet që kanë kontribuar në këtë data base. Pas këtij raportimi, anëtarët mbështetën idenë që secili rajon të emërojë më shumë se një përfaqësues, të cilët do të prezantojnë ILD në seminarin rajonal që do të zhvillohen në të ardhmen dhe të demonstrojnë konkretisht mjetet për plotësimin e tij dhe si mund të shfrytëzohet ai.

Në takim u raportua edhe për aktivitetin trajnues të zhvilluar nga IAIS apo në bashkëpunim me të, si dhe për ato që do të zhvillohen gjatë vitit 2009, ku për AMF paraqesin interes pjesëmarrja në Seminarin Rajonal në lidhje me parimet bazë të IAIS që do të organizohet nga FSI në bashkëpunim me JVI (20-24 Prill 2009, Austri) si dhe pjesëmarrja në seminarin e pestë ndërkombëtar të mbikëqyrjes në sigurime (20 – 24 Korrik 2009 Zvicër).

#### ➤ Komiteti i Zbatimit

Në këtë takim raportuan kryetarët e nënkomiteteve, që përfshihen në këtë komitet në lidhje me aktivitetin e kryer nga këto nënkomitete, si dhe për rezultatet e takimeve të zhvilluara në Basel në kuadrin mbledhjeve tre mujore të IAIS.

## Zhvillohet konferenca mbi edukimin e konsumatorëve, krijimi dhe shpërndarja e programeve të suksesshme

IOSCO, në bashkëpunim me IFIE (Forumi Ndërkombëtar për Edukimin e Investitorëve) organizuan në datat 2-3 mars 2009, Washington DC, konferencën, mbi edukimin e konsumatorëve, krijimi dhe shpërndarja e programeve të suksesshme.

Qëllimi i konferencës, ishte *krijimi dhe promovimi i standardeve më të larta të mundshme për shpërndarjen me efikasitet të edukimit të investitorëve në të gjithë botën*. Kriza globale ekonomike nxori më në pah se kurrë nevojën për edukimin e investitorëve sipas nevojave të çdo vendi.

Konferenca theksoi nevojën për të ndihmuar investitorët në të gjithë tregjet financiare, në mënyrë që të kuptohet më mirë rrisht dhe mundësitë lidhur me investimet dhe procesin e investimeve.

Arritja e këtij qëllimi do të bëhet e mundur nëpërmjet eksportimit të praktikave më të mira të edukimit të investitorëve nga një vend në një vend tjetër, si dhe me edukimin e investitorëve duke bashkëpunuar me rregullatorët dhe shoqërinë civile.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë zhvillimit të konferencës, ishin:

- o **Krijimi i programeve edukuese efektive për investitorët.** Konferenca rekomandoi se duhen gjetur strategjitë nga e gjithë bota për të përzgjedhur programe edukuese që japin rezultat.
- o **Gjetja dhe përdorimi burimeve për programet e edukimit të investitorëve.** Konferenca pohoi se financimi i edukimit të



...Vijon nga numri i kaluar

investitorëve zakonisht është i vështirë, veçanërisht në situata të tilla ekonomike. Prandaj detyrë e rregullatorëve është të mësojnë, se si organizata të ndryshme kanë zhvilluar mekanizma të reja për gjetje fondesh për edukimin e investitorëve.

- o **Reklamimi i edukimit të investitorëve ndaj grupeve të interesuar.** Në konferencë u theksua nevoja e gjetjes së mënyrës së reklamimit të edukimit. Diskutime të shumta u bënë rreth gjetjes së nevojave të publikut për edukim rreth investimeve në përgjithësi, si dhe edukime për investitorë të caktuar.
- o **Drejt edukimit të investitorit në shekullin e 21.** Konferenca theksoi nevojën e përmirësimit thellësisht të edukimit të investitorëve në shekullin 21.

Informacioni i ri, media dhe platformat teknologjike, mund të shërbejnë si katalizatorë për të përmirësuar edukimin e investitorëve në shekullin 21.

- o **Vlerësimi i programeve për edukimin e investitorëve.** Konferenca nxorri në pah nevojën për vlerësimin e programeve ekzistuese edukuese në vende të ndryshme. Edukatorët e investitorëve që nuk vlerësojnë programet e tyre, humbasin një mundësi për të ndërtuar mbështetje publike e private për programet e edukimit të investitorëve, të cilat mund të përmirësojnë gjendjen financiare të investitorëve. Ekzaminimi i mënyrës së përmirësimit të rezultateve dhe rritja e mbështetjes për edukim nëpërmjet vlerësimit, ishte një nga konkluzionet e konferencës.
- o Tema e fundit që u diskutua ishte **e ardhmja e edukimit të investitorit.**

Konferenca konkludoi, se është detyrë e rregullatorëve për të eksploruar domethenien e krizës financiare aktuale dhe gjetjen e mënyrave për edukimin e investitorëve.

## Edukimi i konsumatorit

Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve (Pjesë e shkëputur nga Botimi i IOPS: “Udhëzime për vlerësime të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve”)

### Udhëzimi 2 : Kërkesat e Raportimit

*Kërkesat themelore të raportimit duhet të aplikohen për të gjitha fondet e pensioneve.*

*Megjithëse kërkesat specifike do të përcaktohen nga kërkesat mbikëqyrëse dhe nga struktura e sistemit të pensioneve, duhet të konsiderohen gjithashtu informacioni themelor i fondit, informacioni financiar, informacioni i qeverisjes (duke përfshirë sjelljen e tregut, transparencën dhe politikat për përhapjen e informacionit) dhe informacioni mbi investimet.*

*Informacioni duhet të mblidhet me shpeshtësi, saktësi dhe sasi të përshtatshme, por nuk duhet të mbingarkojë vetë fondet e pensionit dhe kërkesat e raportimit duhet të rishikohen në mënyrë sistematike.*

2. 1 Kërkesat themelore të raportimit duhet të aplikohen tek të gjithë fondet e pensioneve të licencuara ose të regjistruara nën një juridiksion dhe të krijojë bazat për monitorim dhe analizim sistematik. Gjithsesi, një autoritet mbikëqyrës mund të dëshirojë të mbledhë informacion vetëm nga një pjesë e institucioneve (p.sh fondet e mëdha të pensioneve) në mënyrë që të sigurojë më shumë informacion të detajuar mbi shtrirjen e riskut, i cili mund të mblidhet nga të gjithë fondet (anketimet, p. sh, mund të jenë një instrument për të bërë këtë).

2. 2 Autoriteti mbikëqyrës vendos brenda kuadrit



kombëtar ligjor dhe kushtet e tregut, çfarë informacioni të kërkojë, në cilën formë dhe sa të detajuar, nga cili dhe me cilën shpeshtësi. Kërkesat për raportim janë kryesisht një reflektim i nevojave mbikëqyrëse, duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe riskun me të cilin përballet fondi i pensioneve e kështu do të variojë sipas situatës së përgjithshme në sektorin e pensioneve. Ato gjithashtu mund të reflektojnë situatën tek fondet individuale të pensioneve dhe efektivitetin e menaxhimit të tyre të riskut.

2. 3 Sipas natyrës së sistemit të pensioneve, në strukturën e autoritetit mbikëqyrës dhe procedurat e tij, ky informacion duhet të kërkohet me një shpeshtësi të përshtatshme (ditore, javore, mujore, tre mujore, vjetore, tre vjetore, si dhe gjithashtu kërkesa sipas rastit).

2. 4 Informacioni i kërkuar mund të jetë retrospektiv, aktual ose prespektiv (p.sh duke përfshirë “testimet e qëndrueshmërisë” “stress testing”).

2. 5 Në vendosjen e kërkesave për raportim, autoriteti mbikëqyrës duhet të synojë për një balancë të përshtatshme ndërmjet nevojës për informacion, për qëllime të mbikëqyrjes dhe ngarkesës administrative që ajo vendos mbi fondet e pensioneve. Duhet të optimizohen kostot që shoqërojnë procesin e mbledhjes së informacionit. Për shembull, informacioni duhet, aq sa është e mundur, të jetë i disponueshëm dhe në një format të përshtatshëm për fondin.

2. 6 Afati për raportimin sistematik duhet bërë sa më shpejt dhe i praktikueshëm pas përfundimit të periudhës me të cilin raportimi është i lidhur. Penalitete për raportime false, jo të plota ose të vonuara, mund gjithashtu të jenë mjete të dobishme.

2. 7 Herë pas here, autoriteti mbikëqyrës duhet të rishikojë kërkesat e tij për raportime sistematike dhe të rregullta, për t'u siguruar, në mënyrë që ato t'i shërbejnë akoma synimeve për të cilat janë vendosur dhe që po përdoren në mënyrë efçente dhe efektive. Në rastin kur vendosen të prezantohen kërkesa të reja apo të ndryshuara të raportimit, një periudhë e përshtatshme

tranzitore duhet t'u jepet fondeve të pensioneve për të siguruar që ato janë në pozicionin për të dhënë informacionin në mënyrën e duhur dhe brenda afateve.

2. 8 Siç u theksua, sasia e informacionit e kërkuar në raportimet sistematike tek autoriteti mbikëqyrës, do të varet nga natyra dhe risku i fondit të pensionit dhe sistemit të mbikëqyrjes. Raportet duhet të përmbajnë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare, zbulimet ndaj risqeve, mënyrat se si këto zbulime ndaj risqeve janë menaxhuar, si dhe bazat, metodat dhe supozimet mbi të cilat informacioni është përgatitur, duke përfshirë politikat e kontabilitetit dhe informacionin mbi funksionet e dhëna në sipërmarrje. Gjithashtu, duhet të jepet dhe informacion për vlerësimin e performancës së investimeve të fondit. Përveç regjistrimeve të transaksioneve dhe performancës historike, mund të kërkojnë dhe testimet e qëndrueshmërisë (eng. stress-testing) për të vlerësuar ndikimin potencial të lëvizjeve të aseteve tek fondi i pensioneve. Duhet të shqyrtohet, gjithashtu, dhe informacioni mbi nivelin e kontributeve. Në rastin e fondeve me përfitime të përcaktuara, aty ku aplikohet, duhet të merret dhe informacion mbi pozicionin financiar të sponsorizuesit të planit dhe mënyrën se si kjo mund të ndikojë në fondin e pensioneve (edhe pse ky informacion mund të merret nga burime të tjera veç vetë fondit). Përveç të dhënave financiare, duhet të merret dhe informacion i lidhur me mekanizmat e qeverisjes së fondit të pensioneve, i cili mund të përfshijë sjelljen e tregut, transparencën dhe politikat e dhënies së informacionit.

2. 9 Lloji i informacionit, i cili mund të kërkohet, mund të klasifikohet në kategoritë e mëposhtme (edhe pse kjo listë nuk mund të merret si kufizuese) me këtë përmbledhje aktuale, e cila varet nga sistemi i pensioneve dhe metoda e mbikëqyrjes:

a. *Informacion Themelor i Fondit*: Lloji i fondit, statusi i tij, numri i anëtarëve dhe pensionistëve aktivë dhe të mëvonshëm, lëvizjet në numër gjatë periudhës, pranushmëria e përfitimeve dhe aksesit në

- plan, përfitimi i të drejtave, procesi i shkrirjes dhe likuidimit, procedurat e dhënies së informacionit e mekanizmat e rivendosjes.
- b. *Informacion Financiar*: Vlera e fondit, vlera e detyrimeve, vlera e kontributeve të marra, vlerat e transfertave, vlera e të ardhurave nga investimet, vlera e përfitimeve të paguara e portofoli i “testimeve të qëndrueshmërisë”.
- c. *Informacion mbi Qeverisjen*: Struktura dhe mandati i bordit drejtues, procedurat e emërimit dhe kualifikimet e anëtarëve, procedurat e vendimmarrjes, procedurat e menaxhimit të riskut (siç janë programet e brendshme të përputhshmërisë), detaje mbi ofruesit e shërbimeve dhe funksionet e realizuara nga palë të jashtme (aktuarët, auditorët, rojet, menaxherët e investimeve, etj.) duke përfshirë mënyrën se si caktohen, monitorohen e pushohen dhe plan për detaje mbi sponsorizime.
- d. *Administrim i Informacionit të Biznesit*: Politikat mbi transparencën dhe vënien në dispozicion të informacionit, duke përfshirë se çfarë informacioni i transmetohet anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensionit dhe në cilën formë.
- e. *Informacion mbi Investimet*: Strategjia e investimeve, shpërndarja e aseteve, detaje mbi transaksionet, performanca e investimeve, kostot dhe tarifat e ngarkuara.
- 2.10 Informacioni i kërkuar mund të mblidhet nga burime të ndryshme, duke përfshirë si më poshtë:
- a. Kontrata ose nene të fondit të pensionit dhe marrëveshjen e financimit me planin e sponsorizimit.
- b. Pasqyrat financiare (duke përfshirë raportet aktuariale dhe të auditimit).
- c. Të ardhurat vjetore ose raporte specifike të kërkuara nga mbikëqyrësi.
- d. Transaksionet (siç janë raportet tremujore mbi investimet).
- e. Raporte nga ofruesit e shërbimeve, që sigurojnë shërbimet e realizuara nga palë jashtë fondit të pensioneve.
- f. Raporte nga autoritete të tjera mbikëqyrëse.
- g. Konsultim periodik, ndërmjet autoritetit

mbikëqyrës dhe anëtarëve të bordit drejtues të fondit të pensioneve.

- h. Raporte paralajmëruese nga ofruesit e shërbimeve, anëtarët dhe përfituesit ose administratorët e fondit.

### Udhëzimi 3: Informacion Tjetër

*Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve, duhet të kenë autoritetin, gjithashtu të kërkojnë informacion mbi baza rastësore, duke përfshirë rastet kur janë identifikuar probleme ose pasaktësi dhe të kenë fuqinë të vendosin masa për mosraportim. Fondeve të pensioneve duhet t'u kërkohej të azhurnojnë menjëherë autoritetin e mbikëqyrjes së pensioneve mbi ndryshimet, të cilat mund të kenë një ndikim material të mjaftueshëm mbi vlerësimin e nivelit të tyre të riskut dhe kushteve të tyre. Autoriteti mbikëqyrës duhet të mbledhë informacion dhe të prodhojë analiza mbi gjendjen e përgjithshme të pensioneve.*

3.1 Informacion mund t'i kërkohej fondeve të veçanta të pensioneve mbi baza rast pas rasti. Zhvillime të reja mund të kërkojnë, që autoriteti mbikëqyrës të bëjë analiza dokumentare për sektorin në tërësi, të cilat do mund të kërkojnë që fondet e pensioneve të sjellin pranë autoritetit informacion mbi baza rastësore.

3.2 Autoriteti mbikëqyrës duhet t'i kërkojë fondeve të pensioneve të raportojnë menjëherë çdo ndryshim, i cili mund të ndikojë në vlerësimin që mbikëqyrësi ka bërë mbi situatën e tij dhe që është mjaftueshëm material për të ndryshuar në mënyrë thelbësore vlerësimin e riskut (i cili mund të përfshijë ndryshimet lidhur me fondin ose me punëdhënësin që lidhet me fondin). Veprime proporcionale pasuese duhet të ndërmerren, atëherë kur ndryshimet e raportuara janë të prirura të ndikojnë në nivelet e riskut të fondit.

3.3 Në rast se dyshohet ose identifikohen probleme, autoriteti mbikëqyrës mund të kërkojë informacion shtesë nga një fond pensionesh (për shembull procesverbalet nga Bordi Drejtues, bordi menaxhues ose takimet e kujdestarëve të aseteve,

kontrata me menaxherët e aseteve ose ofruesit e tjerë të shërbimeve, etj.).

3.4 Autoriteti mbikëqyrës duhet të kërkojë që informacioni i pasaktë është korrigjuar dhe të ketë autoritetin për të vendosur sanksione për raportim të gabuar.

3.5 Përveç mbledhjes dhe analizimit të informacionit mbi fondet individuale të pensioneve, autoriteti mbikëqyrës duhet të kërkojë për të marrë, dhe më pas për të publikuar, informacion mbi situatën e përgjithshme të pensioneve. Autoriteti mbikëqyrës duke përdorur burime kryesore të disponueshme informacioni, duhet të monitorojë dhe analizojë faktorët kryesorë, të cilët mund të kenë një ndikim tek fondet e pensioneve dhe tek tregu i fondeve të pensioneve, atëherë Autoriteti mund të dalë në konkluzione dhe të ndërmarrë veprime korrigjuese. Analiza të tilla të tregut mund të ndihmojnë në identifikimin e risqeve dhe të dobësive, mbështet ndërhyrjet e mbikëqyrjes dhe forcon kuadrin mbikëqyrës, më qëllim për të reduktuar mundësinë dhe ashpërsinë e ndodhjes së problemeve në të ardhmen. Në varësi të llojit të sistemit të pensioneve, autoriteti mbikëqyrës mund gjithashtu të kërkojë për të vlerësuar nivelin e mbrojtjes së konsumatorit dhe të nivelit të konkurrencës në tregun e fondeve të pensioneve. Tashmë dihet që për realizimin e analizave më të thelluara mbi tregun, kërkohen burime të kualifikuara.

3.6 Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e këtij informacioni mbi funksionimin e fondeve të pensioneve tek publiku. Dhënia e informacionit në përgjithësi do të jetë në baza të përgjithshme por gjithashtu mund të jetë edhe mbi fonde individuale të pensioneve, raste në të cilat rregullat e konfidencialitetit janë veçanërisht të rëndësishme.

3.7 Një analizë sasiore e tregut mund të përfshijë, për shembull, zhvillimet në përgjithësi në tregjet financiare, numrin e fondeve të pensioneve të cilat hyjnë / ose dalin nga tregu, treguesit e tregut siç është konsolidimi, nivelet e financimit, struktura e investimeve, zhvillimi i produkteve të

reja dhe pjesa e tregut, kanalet e shpërndarjes, etj.

3.8 Një analizë cilësore e tregut mund të përfshijë, për shembull, raportimin mbi zhvillime të përgjithshme, të cilat mund të kenë ndikim në fondet e pensioneve si, sektori financiar i ri ose i ardhshëm dhe legjislacioni tjetër i rëndësishëm, risqet e reja dhe kontrollet, zhvillimet në praktikat dhe metodat e mbikëqyrjes, etj.

#### **Udhëzimi 4: Analiza**

*Pasi autoriteti mbikëqyrës i pensioneve ka mbledhur informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e fondit të pensioneve, një numër analizash dhe kontrollesh duhet të ndërmerren, të cilat mund të mbulojnë çështje të pajtueshmërisë ligjore, fuqisë financiare, menaxhimit të riskut, sjelljen e tregut, qeverisjen, dhënien e informacionit, funksionet dhe performancën, sipas metodës së riskut të mbikëqyrësit.*

4.1 Pasi autoriteti mbikëqyrës ka mbledhur informacionin e nevojshëm për të bërë një vlerësim të pozicionit të një fondi pensionesh, mund të bëhen forma të ndryshme analizash. Përsëri në varësi të kontekstit, sipas të cilit autoriteti mbikëqyrës është duke vepruar dhe zbulimit potencial ndaj riskut të fondit, këto mund të përhijnë si më poshtë:

- a. *Kontrollet e përputhshmërisë:* Për t'u siguruar, nëse fondi është në përputhje me detyrimet ligjore dhe udhëzimet ndërkombëtare, rregullat e financimit, rregullat për provigjonet teknike dhe të vlerësimit të aseteve, rregullat e investimeve, kërkesat e qeverisjes dhe rregullat e brendshme për financim.
- b. *Kontrollet financiare:* Për të siguruar, nëse është arritur aftësia paguese dhe që “teste të tjera të qëndrueshmërisë”, të cilat janë më specifike të jenë përmbushur.
- c. *Kontrollet e qeverisjes:* Për të kontrolluar, nëse bordi drejtues është i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme dhe është duke funksionuar sipas mekanizmave transparentë, për të kontrolluar që sisteme të përshtatshme të menaxhimit të riskut janë në funksionim, për t'u siguruar që ekzistojnë



sisteme të përshtatshme të emërimit, monitorimit dhe të shkarkimit të ofruesve të jashtëm të shërbimeve, për t'u siguruar që anëtarëve dhe përfituesve të fondit i sigurohet informacion në mënyrë të përshtatshme.

d. *Kontrollet operacionale*: Për t'u siguruar që kontributet po merren, pagesat janë duke u bërë në kohë, ankimimet janë duke u ndjekur, etj.

e. *Kontrollet për dhënien e informacionit*: Për t'u siguruar që fondi i pensioneve po vepron në një mënyrë transparente dhe është duke u dhënë informacion të përshtatshëm anëtarëve dhe përfituesve në një mënyrë të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.

f. *Kontrollet e performancës*: Për t'u siguruar që investimet janë duke u bërë në linjë me politikën e caktuar dhe tolerancën ndaj riskut, që të ardhurat e investimeve janë në linjë me modelet apo grupet krahasuese dhe divergjencat materiale mund të shpjegohen, e që kostot dhe tarifat janë në nivele të arsyeshme.

4.2 Pasi është mbledhur informacioni i kërkuar, autoritetet e mbikëqyrjes së pensioneve duhet të krijojnë procese për të analizuar këto të dhëna në mënyrë efçente dhe efektive.

4.3 Mënyra dhe shtrirja me të cilën autoritetet e mbikëqyrjes së pensioneve analizojnë dhe vlerësojnë informacionin që ato marrin nga fondet e pensioneve, do të varet nga sistemi i pensioneve dhe kuadri rregullator. Disa mjedise rregullatore janë të bazuara në standarde sasiore, të cilat kërkojnë që autoriteti mbikëqyrës të ndërmarrë masa më një periodicitet të caktuar, duke krahasuar statusin financiar të fondeve të pensioneve dhe aktivitete me standardet normative. Struktura të tjera rregullative janë orientuar drejt analizave më shumë krahasuese dhe vlerësojnë fondet gjatë një periudhe të gjatë, kundrejt krahasimeve të sjelljeve për industrinë e pensioneve në tërësi.

## **Udhëzimi 5: Procesi i vlerësimit të riskut**

*Përveç kontrollit të përputhshmërisë, autoriteti i mbikëqyrjes së pensioneve duhet të vlerësojë fondet e pensioneve për nivelet e riskut që kalojnë tek anëtarët*

*dhe përfituesit e tyre dhe sistemin e pensioneve, nëse është i përshtatshëm.*

*Sistemet e llogaritjes së risqeve, duke përdorur në mënyrë të qëndrueshme faktorë sasiore dhe cilësorë, mund të përdoren, duke vlerësuar riskun në kontekstin e ndikimit potencial ashtu dhe të probabilitetit të ndodhjes.*

5.1 Procesi i mbikëqyrjes së pensioneve, nuk duhet të konsistojë vetëm në kërkimin e të dhënave dhe në të kontrolluarin e përputhshmërisë me rregullat. Pasi informacioni të jetë mbledhur, kontrolluar, dhe identifikuar problemet potenciale, mbikëqyrësit duhet të vlerësojnë një fond në terma të nivelit të riskut të kaluar anëtarëve dhe përfituesve dhe sistemit të pensioneve në tërësi. Gjithashtu, duhet të vlerësohet dhe aftësia e menaxhimit të riskut të fondit të pensioneve.

5.2 Sisteme të klasifikimit të riskut, duke përdorur në mënyrë të vazhdueshme faktorë sasiore dhe cilësorë, mund të përdoren për vlerësimin e riskut në kontekstin e ndikimit potencial, si dhe të probabilitetit të ndodhjes. Si rrjedhim, merret një rezultat për vlerësimin e përgjithshëm të riskut për një fond. Kjo lejon mbikëqyrjen e analizës dokumentare të jetë pro aktive dhe pjesë e një metode me bazë risku për mbikëqyrjen e pensioneve, duke sjellë më shumë veprim e dinamikë të mbikëqyrjes me vlerësimin e riskut të fondeve të pensioneve. Klasifikimi i riskut mund të përfshijë reagim automatik sasiore, për shembull, nëse dokumente të caktuar nuk janë dorëzuar ose disa limite janë shkelur (p.sh limitet e investimeve). Gjithashtu, do të kërkohen faktorë cilësorë, të cilët të përfshijnë gjykimin e mbikëqyrësit, për shembull, nëse një strategji investimi është gjykuar e parregullt ose përbërja e bordit e pazakontë. Si faktorët nga të dhënat historike, probleme mund të identifikohen nga përdorimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm, për shembull, teste të qëndrueshmërisë mund të përdoren për të analizuar se si do të reagojnë portofolet ndaj kushteve të ardhshme të tregut.

5.3 Vlerësime të tilla të riskut, përgjithësisht

përfshijnë analizën e ndikimit potencial, si dhe probabilitetin e ndodhjes. Autoriteti mbikëqyrës ka nevojë të aplikojë një metodë logjike dhe të qëndrueshme të selektimit, renditjes dhe peshës së faktorëve të riskut, në mënyrë që të dilet më një metodë të plotë të llogaritjes së riskut. Për të siguruar një qëndrueshmëri të tillë, mund të dizajnohet një proces i brendshëm i rishikimit më të kujdesshëm.

5.4 Rezultatet e një vlerësimi të tillë të riskut dhe renditjes potenciale, duhet të përdoren për të drejtuar pozicionin dhe metodën e mbikëqyrjes së vetë autoritetit mbikëqyrës drejt fondeve të pensioneve. Për shembull, një renditje e lartë e nivelit të riskut, mund që potencialisht të japë shkak për një investigim më të thelluar në të ardhmen.

***Për këtë numër punuan:***

A. Qamo, E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori,  
T. Cani, A. Dervishi, R. Eltari, E. Zalta,  
E. Kokona

